

VENDIM
Nr.626, datë 21.9.2004

PËR MIRATIMIN E LISTAVE TË INVENTARIT DHE TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKIVE DHE KOMUNAVE TË DISA PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETËTËRORE, QË DO TË PËRDOREN PËR NGRITJEN E QENDRAVE TË SHËRBIMEVE SOCIALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 7 e 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale dhe të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të ish-kinemasë së qytetit të Pukës e të anekseve të saj dhe kalimin në pronësi të bashkisë së Pukës, sipas formularit, planimetrisë dhe planvendosjes, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Miratimin e listës së inventarit të ish-mensës së punëtorëve të fabrikës së qelqit në Kavajë dhe kalimin e saj në pronësi të bashkisë së Kavajës, sipas formularit, planimetrisë dhe planvendosjes, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

3. Miratimin e listës së inventarit të ish-shtëpisë së kulturës Vaqarr dhe kalimin e saj në pronësi të komunës Vaqarr, sipas formularit, planimetrisë dhe planvendosjes, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

4. Miratimin e listës së inventarit të çerdhes nr.4 në Vlorë dhe kalimin e saj në pronësi të bashkisë së Vlorës, sipas formularit, planimetrisë dhe planvendosjes, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

5. Miratimin e listës së inventarit të çerdhes nr.15 në Vlorë dhe kalimin e saj në pronësi të bashkisë së Vlorës, sipas formularit, planimetrisë dhe planvendosjes, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

6. Miratimin e listës së inventarit të lavanderisë së shtëpisë së të moshuarve në Shkodër dhe kalimin e saj në pronësi të bashkisë së Shkodrës, sipas formularit, planimetrisë dhe planvendosjes, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

7. Miratimin e listës së inventarit të shtëpisë së foshnjës “H.S. Andersen” në Shkodër dhe kalimin e saj në pronësi të bashkisë së Shkodrës, sipas formularit, planimetrisë dhe planvendosjes, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

8. Miratimin e listës së inventarit të ndërmarrjes së shërbimeve mekanike në ish-kombinatit e drurit “Misto Mame” në Tiranë dhe kalimin e saj në pronësi të Bashkisë së Tiranës, sipas formularit, planimetrisë dhe planvendosjes, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

9. Miratimin e listës së inventarit të ndërmarrjes së riparimeve të materialeve poligrafike, “Ofiçina” në Tiranë dhe kalimin e saj në pronësi të Bashkisë së Tiranës, sipas formularit, planimetrisë dhe planvendosjes, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

10. Mjediset e pronave të paluajtshme shtetërore, që kalojnë në pronësi të organeve të pushtetit vendor, të përmendura në pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 e 9 të këtij vendimi, të përdoren për ngritjen e qendrave për shërbime sociale për komunitetin.

11. Ngarkohen Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, kryetarët e bashkive e të komunave, të përmendur në këtë vendim, dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano